

THE TRANSLATION OF PROPER NOUNS APPEARING IN LITERARY WORKS MBI PËRKTHIMIN E EMRAVE TË PËRVEÇËM NË VEPRAT LETRARE

MIRELA PAPA

Departamenti i Gjuhës Italiane, Universiteti i Tiranës, Tiranë, SHQIPËRI
papamirela@yahoo.com

AKTET V, 4: 699 - 704, 2012

PERMBLEDHJE

Emrat e përveçëm përbëjnë një nga pjesët më të debatueshme në teorinë dhe praktikën e përkthimit. Emrat e përveçëm shërbejnë për të identifikuar një element konkret. Për të dalluar këta emra përdoret kriteri referencial dhe ai semantik. Emrat e përveçëm mund të konsiderohen "etiketa" identifikuese, por semantikisht boshe. Nga ana tjetër, siç vë në dukje Newmark-u, ky grup fjalësh mund të kërkojë një njohje kulturore apo enciklopedike, pavarësisht se nuk kanë kuptim gjuhësor, prandaj edhe nuk përfshihen në një fjalor, por në një enciklopedi. Në këtë kumtesë do të shikojmë konkretisht se si janë përkthyer në gjuhën shqipe emrat e përveçëm në vepra të ndryshme të letërsisë italiane. Do merren në konsideratë dy blloqe emrash: antroponimet dhe toponimet. Nisur nga shembuj konkretë të vjelë nga tekstet e përkthyer do përcaktojmë strategjitë që kanë ndjekur përkthyesit shqiptar për përkthimin e dy kategorive të emrave të përveçëm: emrave konvencionalë dhe atyre shprehës.

Fjalët kyçe: përkthim, emra të përveçëm, semantikë, letërsi.

SUMMARY

Proper nouns constitute one of the most debatable points in Translation Theory and Practice. They serve to identify a concrete element. In order to identify these nouns two types of criteria are used: referential and semantic. The proper nouns may be considered identifying "labels" but semantically empty. However, as Newmark points out, this particular word group may require some cultural or encyclopedic knowledge, although these nouns have no linguistic meaning, which explains why they have no dictionary entries and are, instead, found in encyclopedias. This paper explores, in more concrete terms, how proper nouns appearing in different works of Italian literature are translated into Albanian by focusing on antroponyms and toponyms. Based on genuine instances of proper nouns observed in translated texts we will determine what strategies Albanian translators have adopted for translating two categories of proper nouns: conventional nouns and expressive nouns.

Key words: translation, proper nouns, semantics, literature.

Hyrje

Emrat e përveçëm përbëjnë një nga pjesët më të debatueshme në teorinë dhe praktikën e përkthimit. Janë të shumta punimet e huaja që kanë trajtuar këtë temë, që nga qasjet parashkruese, tek ato përshkruese. Në këto punime është përpjekur të përshkruhet kjo kategori fjalësh, duke ndjekur tri kritere bazë: (a) kriterin formal (ortografik dhe morfosintaksor), (b) kriterin referencial dhe (c) atë semantik.

Hermans-i (1985: 13), nga pikëpamja e studimeve përshkruese në fushën e përkthimit, dallon dy kategori të emrave të përveçëm sipas shkallës së «semantizimit»: *conventional names* (konvencionalë) dhe *loaded names* (shprehës). Të parët përbëhen nga fjalë të cilave u mungon ngarkesa semantike, domethënë, në përbërjen e tyre nuk ka asnjë aluzion për natyrën e referentit (p.sh. Torino, Roma etj.). Shprehës janë emrat e përveçëm të semantizuar, të pajisur me kuptim dhe/apo konotacione që tentojnë të përfshijnë

në formimin e tyre fjalë që u përkasin kategorive me një ngarkesë të përcaktuar semantike (p.sh. «Lodoletta» që vjen nga fjala *lodola* që në shqipe do të thotë *laureshë* etj.).

Për sa i përket mënyrës së përkthimit të emrave të përveçëm Franco Aixelá-ja i ndan procedimet teknike në dy grupe të mëdha: ruajtje dhe zëvendësim, sipas faktit nëse përkthimi është i orientuar drejt polit të origjinës (përshtatje) apo drejt polit mbërritës (pranueshmëri).

Strategjitë përkthimore që mëtojnë ruajtjen janë: *përsëritja*; *përshtatja ortografike*; *përkthimi gjuhësor*; *glosa jashtëtekstuale*; *glosa brendatekstuale*.

Përballë strategjive të ruajtjes, ato të zëvendësimit orientohen drejt polit mbërritës dhe përmes tyre përkthyesi synon të zvogëlojë apo të neutralizojë ekzotizmin apo papranueshmërinë kulturore të referentit original. Kësaj kategorie i përkasin këto procedime: *neutralizimi i kufizuar*; *neutralizimi absolut*; *natyralizimi*; *përshtatja ideologjike*; *heqja*; *krijimi autonom*.

Për të bërë një studim të përkthimit të emrave të përveçëm që shfaqen në tekstet letrare kemi marrë në analizë romanin e shkrimtarit italian Luixhi Pirandelo *Il fu Mattia Pascal* i përkthyer në gjuhën shqipe nga Sabah Ramja dhe Violanda Canko. Është përzgjedhur ky roman, sepse kemi dy përkthime nga përkthyes të ndryshëm. Kjo na ka shërbyer që të krahasojmë edhe strategjitë që ka ndjekur secili nga përkthyesit. Nga pikëpamja metodologjike i kemi klasifikuar segmentet tekstuale të përzgjedhura në dy blloqe të mëdha, duke ndjekur modelin e sugjeruar nga Torre-ja (1994: 99) dhe të bazuar te lloji i referentit që përfaqësojnë këta emra: antroponime (emrat e personave), toponime (emrat e vendeve).

I. Antroponimet

Emrat e përveçëm dhe mbiemrat e personazheve të një veprë letrare kanë si funksion themelor të prezantojnë këta të fundit te lexuesi. Lidhur me këtë aspekt të leksikut të Pirandelos janë bërë, sipas mendimit tonë, pak studime. Mes tyre mund të përmendim studimin e bërë nga Benvenuto Terracini *Considerazioni*

sullo stile delle novelle di Luigi Pirandello, ku merret në mënyrë të veçantë me emrat dhe mbiemrat e përdorur në novelat pirandeliane. Edhe Leonardo Shasha e ka trajtuar këtë temë në esenë e tij me titull «Pirandello dalla A alla Z», i botuar në të përditshmen '*l'Espresso*' në përkujtim të 50-vjetorit të vdekjes së shkrimtarit. Sipas Terracinit: «Emri dhe mbiemri janë veçse një etiketë, një shenjë e gënjeshtërt dhe e ndryshueshme e maskës që ka marrë personazhi në pjesën që i takon të recitojë».

Me objektivin që të bëhet një studim i përkthimit të antroponimeve që dalin në këto romane, segmentet e përzgjedhura tekstuale janë klasifikuar në disa nëngrupe në funksion të referentit: personazhe të romanit; persona realë që kanë një ekzistencë jashtë universit të trillimit letrar; emra personazhesh mitologjike e biblike dhe tituj fisnikërie.

I.1. Personazhe të romanit

Emrat e personazheve të këtyre romaneve u përkasin grupeve të antroponimeve konvencionale dhe antroponimeve shprehëse.

I.1.1 Antroponimet konvencionale

Antroponimet konvencionale, siç e kemi thënë më lart, janë ata që nuk kanë një përmbajtje gjuhësore. Për sa u përket strategjive përkthimore, vihet re te përkthyesit një përsëritje e segmentit tekstual me përshtatje ortografike në gjuhën e përkthimit, duke ndjekur normat në fuqi. Në *Drejtshkrimin e gjuhës shqipe* (botim i Akademisë së Shkencave të RP të Shqipërisë dhe Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë), në faqen 104 thuhet: «*Shkrimi i emrave të përveçëm të huaj mbështetet përgjithësisht në shqiptimin e tyre në gjuhët përkatëse, duke iu përshtatur sistemit grafik të shqipes*».

Kështu kemi: «Adriano Meis» **Adriano Meis**, «Roberto» ose «Berto» **Roberto** ose **Berto**, «Guendalina» **Guendalina**, «Romilda» **Romilda**, «Romitelli» **Romiteli**, «Filippo» **Filipo**, «Miro Colzi» **Miro Kolci**, «Tito Lenzi» **Tito Lenci**, «Anselmo Paleari» **Anselmo Paleari**, «Adriana Paleari» **Adriana Paleari**, «Terenzio Papiano» **Terenco Papiano**, «Francesco Meis» **Francesko Meis**, «Ignazio Giglio d'Auletta» **Injacio Xhilio**

d'Auleta, «Antonio Pantogada» **Antonio Pantogada**.

Për emrat e huaj të personazheve si në rastin e «Manuel Bernaldez» **Manuel Bernaldez** strategjia përkthimore është ajo e përsëritjes (emri lihet siç është në origjinal).

Ndër emrat konvencionalë të personazheve ndeshim edhe të tillë që mund të kenë një kuptim etimologjik.

«Gerolamo Pomino» **Gerolamo Pomino**, «Gerolamo II Pomino» **Gerolamo Pomino II** (*pomo* në italisht do të thotë *mollë*), «Scipione Papiano» **Shipione Papiano**, (emri të kujton fare lehtë fjalën *scippo* që do të thotë *grabitje*). Është vëllai i Terenco Papianos dhe është ekzekutori material i vjedhjes së parave që i bëhet Matia Paskalit), «Mattia Pascal» **Matia Paskal**, (që është variant i emrit Matteo, që në hebraisht do të thotë «njeri i Zotit»).

Për sa i përket strategjisë përkthimore të këtyre emrave konvencionalë, vëmë re se të dy përkthyesit përdorin përshtatjen ortografike.

I.1.2. Antroponimet shprehëse

Krahas antroponimeve konvencionale kemi edhe *antroponimet shprehëse*, të cilat shtojnë një konotacion apo informacion për të ndihmuar në karakterizimin e personazhit. Karakteristikë e pothuajse të gjithë personazheve të Pirandelos është se janë emra që flasin, domethënë janë emra, të cilët emërtojnë karakteristikat e personazhit.

Mund të dallojmë disa kategori antroponimesh që bartin një ngarkesë semantike domethënëse. Kemi emra, mbiemra dhe nofka.

Kështu në roman kemi:

«Zia Scolastica» halla **Skolastika**, *skolastika* është tërësia e disiplinave filozofike, teologjike dhe shkencore të përpunuara në epokën mesjetare si mbështetje e së vërtetës fetare. Personazhi i emërtuar në këtë mënyrë është një grua racionale, e rreptë dhe e zgjuar, një lëneshë me karakter të vendosur dhe krenar, nevrike dhe impulsive. Për këtë emër strategjia përkthimore e të dy përkthyesve është përshtatja ortografike që përkon në këtë rast edhe me përkthimin gjuhësor.

«Oliva Salvoni» *oliva* në gjuhën italiane është ulli (fryt). Për këtë emër strategjia përkthimore të të dy përkthyesve janë herë përsëritja **Oliva** dhe herë natyralizimi **Olivia**.

«Margherita» është një lloj luleje në gjuhën italiane dhe i njëjti emër është huazuar edhe në shqipe për këtë lule. Strategjia përkthimore është natyralizim i emrit në **Margarita**. Nëse do të kishin preferuar përshtatjen ortografike, do të kishin përdorur Margerita, por e kanë natyralizuar me emrin që ekziston edhe në gjuhën shqipe për femrat dhe është pikërisht Margarita.

«Pepita Pantogada» është një personazh i huaj. Pepita në spanjisht do të thotë 1. farë, bërthamë 2. miner. copë ari etj. 3. am. kokërr kakaoje. Strategjia përkthimore e ndjekur nga të dy përkthyesit është përsëritja e emrit **Pepita Pantogada**.

«Candida» në italisht do të thotë (fig.) i dëlirë, i patëkeq, i çiltër, i pafaj. Në përkthim përkthyesit kanë ndjekur strategjinë e përshtatjes ortografike **Kandida**.

Për sa u përket mbiemrave shprehës kemi «Eligio Pellegrinotto», ku me *pellegrino* në italisht nënkuptohet *pelegrini*, *shtegtari*. Në përkthim RAMJA ndjek herë përshtatje ortografike me natyralizim **Pelegrinoti**, herë kondensim **Pelegrino**, ndërsa CANKO ndjek strategjinë e përshtatjes ortografike **Pelegrinoto**.

«Vedova Pescatore» jo më kot mbiemri është ndër ata që emërtojnë mirë personazhet, *pescatore* që do të thotë *peshkatar*, sepse është një peshkatore shumë e aftë kjo grua për të peshkuar pretendentët për të bijën Romilda. Strategjia përkthimore e ndjekur është e njëjtë për të dy përkthyesit përshtatje ortografike veçjusha **Peskatore**.

«Silvia Caporale» edhe ky personazh ka një mbiemër me ngarkesë semantike; *caporale* do të thotë 1. rreshter 2. (thjeshtligj) kryepunëtor. Strategjia përkthimore është përshtatja ortografike **Silvia Kaporale**.

Për sa u përket nofkave, kemi «Pinzone» që është një nofkë që sintetizon karakteristikat fizike të personazhit. Shumë i gjatë dhe shumë i dobët, burri duket vërtet si një pincë e madhe: dobësia e

tij të ngjall neveri, është pak i kërrusur, me një qafë që del me vështirësi nga trangu dhe vë në dukje mollën e Adamit kur lëviz. Strategjia përkthimore është e njëjtë, ajo e përshtatjes ortografike **Pincone**.

«Lodoletta» është një nofkë me ngarkesë semantike. *Lodola* në italisht do të thotë *laureshë*. RAMJA ndjek strategjinë e përshtatjes ortografike **Lodoleta**, ndërsa CANKO atë të përkthimit gjuhësor, por e përkthen gabimisht **Fajkoi**.

I.2. Persona realë

Në nëngrupin e dytë të antroponimeve kemi përfshirë emrat dhe mbiemrat e personave realë, domethënë individë që kanë një ekzistencë të tyren në një çast të caktuar historik dhe që përmenden në këtë vepër letrare. Ky është rasti i shkrimtarëve, filozofëve, njerëzve të politikës, fisnikëve etj. italianë, por edhe të huaj.

Kështu në roman kemi:

«Giulio Cesare Croce» (poet bolonjz) CANKO përdor përkthim për emrin dhe përshtatje ortografike për mbiemrin **Julio Çezare Kroçe**, ndërsa RAMJA përdor përshtatjen ortografike **Xhuljo Çezare Kroçe**.

«Francesco Moneti» (prift poet) **Françesko Moneti**, «Catone l'Uticense» (poet) **Katone l'Utiçense**, «Stigliani» (autor poemash) **Stiliani**. Strategjia është përshtatja ortografike.

«Giustino Martire» (shkrimtar grek) CANKO **Justin Martiri**, RAMJA **Xhustino Martire**. Te të dy shkrimtarët strategjia është e njëjtë, përshtatje ortografike me përpjekje natyralizimi nga ana e CANKOS.

«Boccaccio» **Bokaçio** është ndjekur strategjia e përshtatjes ortografike, ndonëse forma e saktë do të ishte Bokaço. «Giacomo Leopardi» **Xhakomo Leopardi**, «Niccolò Tommaseo» (shkrimtar, poet dhe kritik) **Nikolo Tomazeo**.

Në rastin e «Copernico» **Koperniku**, «Cicerone» **Ciceroni**, «Sophocle» **Sofokliu**, «Quintiliano» **Kuintiliani** është përdorur si strategji natyralizimi dhe përshtatja ortografike, duke u mbështetur në rregullat e drejtshkrimit të gjuhës shqipe.

Për sa u përket emrave të shkencëtarëve, njerëzve të politikës, të artit apo të fesë kemi:

«Newton» **Njutoni**, «Giovan Vittorio Soderini» **Xhiovani Vitorio Soderini**, «Tertulliano» **Tertuliani**, «Camillo De Meis» **Kamilo De Meis**, «Cirillo d'Alessandria» **Cirili i Aleksandrisë**, «papa Leone XIII» **papa Leone XIII**, «Perugino» **Peruxhino**, «Raffaello» **Rafaelo**, «Teresa Ravaschieri Fieschi» **Tereza Ravaskieri Fieski**, «Pietro Ulloa» **Pietro Ulloa**, «Garibaldi» **Garibaldi**, «Ferdinando e Francesco II» **Ferdinandi dhe Françesku II**, shikojmë se si strategji e përkthyesve është ajo e përshtatjes ortografike, e pasuar nga ndonjë tentativë për natyralizim.

Për emrat e personazheve realë të huaj «Finot» (shkrimtar francez) CANKO **Finoti**, RAMJA **Pinot**, «Leadbeater» **Leadbeater** strategjia është ajo e përsëritjes e ndërthurur me përshtatjen ortografike.

I.3. Personazhe biblike apo mitologjike

Një nëngrup i tretë përbëhet nga emrat e personazheve biblike apo mitologjike që përmenden në roman.

Nuk janë të shumtë kemi: «Giosuè» (një mbret antik biblik) RAMJA gabimisht e përkthen **Jezusi**, ndërsa CANKO e përshtat ortografikisht **Xhozue**.

«Lucina» (në antikitet ishte perëndesha që mbronte gratë që lindnin) **Luçina**, të dy përkthyesit ndjekin strategjinë e përshtatjes ortografike.

«Rea Silva» **Rea Silva**, strategjia është ajo e përsëritjes në tekstin e përkthyer.

«Tantalo» (një nga bijtë e shumë të Zeusit), **Tantali** strategjia e ndjekur është ajo e natyralizimit.

II. Toponimet

Lidhur me toponiminë mund të themi se Pirandelo përshkruan me detaje emrat e maleve, krahinave, kishave. Pavarësisht nga kjo, vendndodhja e rrëfimeve të tij është e vështirë të përcaktohet. Në lexim e sipër marrim informacion se ku zhvillohen ngjarjet, në Itali apo jashtë, në ishuj apo në gadishull, por vetëm në pak raste do të përmendet emri i vërtetë i vendit. Vetëm një lexim i vëmendshëm do të lejojë të zbulohet, me aluzione, situata reale e rrëfimit.

Kategoria e toponimeve përfshin emrat e përveçëm të vendeve. Brenda këtij koncepti të përgjithshëm, segmentet tekstuale të përzgjedhura janë klasifikuar në funksion të referentit në tri grupe: 1) vendet, krahinat, qytetet dhe fshatrat; 2) rrugët, sheshet dhe lagjet; 3) thyerje gjeografike apo formacione natyrore (liqene, male, pyje etj.).

II.1. Emra vendesh, krahinash, qytetesh dhe fshatrash

Për sa i përket grupit të parë, mund të themi se strategjia e ndjekur nga përkthyesit është përdorimi i variantit zyrtar të përkthimit të emrit të qytetit apo krahinës.

«Nizza» **Nica**, «Marsiglia» **Marsejë**, «Montencarlo» **Montekarlo**, «Peterhof» **Peterburg**, «Torino» **Torino**, «Milano» **Milano**, «Roma» **Romë**, «Alenga» **Alenga**, «Colonia» **Këln**, «Corsica» **Korsikë**.

Në rastin e «Basilea» **Bazilea**, ndiqet strategjia e përshtatjes ortografike nga ana e të dy përkthyesve, ndërkohë që mund të ishte përdorur përkthimi zyrtar për këtë qytet që është **Bazel**.

«Mannheim» RAMJA **Manhajm**, CANKO **Manheim**, «Worms» RAMJA **Vorms**, CANKO **Uorms**, «Magonza» RAMJA **Magonza**, CANKO **Mangozë**, «Bingen» **Bingen**, «Coblenza» RAMJA **Koplenx**, CANKO **Koblenc**. Për «Miragno» fshati i Matia Paskalit përdoret përshtatja ortografike nga CANKO **Miragno**, ndërsa RAMJA përdor një përpjekje të kotë, për mendimin tonë, për natyralizim me një emër herë në gjininë mashkullore dhe herë në gjininë femërore, **Mirania**, **Miranio**.

II.2. Emrat e rrugëve, shesheve dhe lagjeve

Për sa i përket grupit të dytë, kemi përshtatjen ortografike si strategji kryesore:

«Piazza Massena» sheshi **Masena**, «via Ripetta» rruga **Ripeta**, «Monte Mario» **Monte Mario**, «Ponte Margherita», **Ponte Margherita**, «via di Chiaja» rruga e **Kiajës**, «via dei Pontefici» rruga e **Papëve**, «Ponte Vecchio» **Ponte Vekio**, «via Borgo Nuovo» rruga **Borgo Nuovo**, «piazza San Pietro» sheshi «**San Pietro**».

«La promenade» «Avenue de la Gare» nuk janë kuptuar nga RAMJA dhe janë përkthyer gabimisht me **Shëtitja në rrugët e Stacionit**. Kemi përsëritje si strategji të CANKOS **Promenade**, **Avenu de la Gare**.

II.3. Emra thyerjesh gjeografike apo formacione natyrore (liqene, male, pyje etj.).

Lidhur me grupin e tretë përmendim: «Campidoglio» **Kampidoljo**, «Gianicolo» **Xhianikolo** (forma e saktë do të ishte Xhanikolo), të dy përkthyesit përdorin strategjinë e përshtatjes ortografike në gjuhën shqipe.

Për pasuritë e patundshme të familjes Paskal (që janë padyshim emra të trilluar nga autori), CANKO përdor strategjinë e përkthimit gjuhësor duke qenë se bëhet fjalë për toponime shprehëse të pajisura me ngarkesë semantike. Kështu kemi «La terra delle Due Riviere» toka e **Dy Brigjeve**, «La poggia dello Sperone» pllaja e **Yzengjive**, «Il podere della Stia» çifligu **Kotecci**. Ndërsa RAMJA për këto toponime përdor përkthimin gjuhësor për njërin nga toponimet dhe përsëritjen me përshtatje ortografike për dy toponimet e tjera: toka e **Dy Lumenjve**, kodrina e **Speronit**, çifligu i **Stias**. Pra nuk kemi një strategji përkthimore homogjene.

Dy fjalë për ta mbyllur

Në përfundim të kësaj analize, për sa u përket emrave të përveçëm të të gjitha nëngrupeve, mund të themi se strategjia kryesore që ndjekin të dy përkthyesit është ajo e përshtatjes ortografike si për emrat e përveçëm konvencionalë, ashtu edhe për ata shprehës, qofshin të tejdukshëm apo jo. Strategjia e dytë në radhë është ajo e përsëritjes, më pas natyralizimi dhe së fundmi disa përpjekje për përkthim të emrave të përveçëm shprehës me ngarkesë semantike.

Sipas Newmark-ut:

...qoftë emrat e përveçëm, qoftë edhe termat kulturorë u referohen personave, objekteve apo proceseve tipike të një komuniteti të vetëm etnik (përbëjnë ato që quhen *realia*), por ndërsa të parët kanë referentë individualë, të dytët u referohen klasave. Teorikisht, emrat e personave

apo objekteve të veçanta janë «të jashtme» në lidhje me gjuhën, u përkasin enciklopedive dhe jo fjalorëve dhe siç ka sqaruar Mill-i, nuk kanë kuptim apo konotacione, prandaj janë të papërkthyeshëm dhe nuk duhen përkthyer (Newmark 1998: 129)

Por kur bëhet fjalë për emra të përveçëm shprehës me ngarkesë semantike, në rastet kur konotacionet dhe kombësia e emrave janë të rëndësishme, Newmark-u (1992: 290) propozon si strategji që të përkthehet fillimisht në GJP përmbajtja e emrit dhe më pas të natyralizohet përkthimi me GJO, në atë mënyrë që rezultati të jetë një emër i përveçëm i ri në këtë gjuhë (p.sh: «Navatov» – «alarma» – «Alarmov»).

Meqenëse emrat e përveçëm të personazheve që përdor Pirandello janë emra «*self-interpreting*» dhe shërbejnë për të karakterizuar më mirë personazhin që emërtojnë, do të ishte më e këshillueshme që strategjia e ndjekur nga përkthyesit të ishte përkthimi i këtyre emrave me ngarkesë semantike ose të jepnin së paku me një glosë jashtëteksuale përkthimin e tyre.

Për sa u përket toponimeve mund të themi se strategjia kryesore që ndjekin përkthyesit është ajo e përshtatjes ortografike për toponimet konvencionale dhe përdorimi i emrit zyrtar për toponimet, varianti i të cilave ekziston tashmë në gjuhën mbërritëse. Për sa u përket toponimeve shprehëse CANKO përdor si strategji përkthimin gjuhësor që është edhe një hap përpara drejt polit mbërritës në krahasim me strategjitë e tjera.

Bibliografia

- CREPALDI C. (nën kujdesin e), (2002) *Sintesi Il fu Mattia Pascal di Luigi Pirandello. Introduzione all'opera. Riassunto e analisi. Approfondimenti. Vita e opere dell'autore*, Avallardi, Milano.
- FRANCO AIXELA J., (1996) *Culture-specific items in Translation*, në Román Alvarez dhe M^a Carmen Africa Vidal, *Translation, Power, Subversion*, Multilingual Matters, Clevedon, 52-78.
- HERMANS Th., (1985) *Translation Studies and a New Paradigm*, tek Theo Hermans (ed.) *The Manipulation of Literature: Studies in Literary Translation*, Croom Helm, Londër, f. 7-15.
- HOXHA G., (1976), *Fjalët italishte në shqipe*, «Rilindja», 13 mars.
- NEWMARK P., (1981) *Approaches to Translation*, Pergamon Press, Oxford.
- PIRANDELLO L., (1994), *Uno, nessuno e centomila, Testo integrale, schede storiche e letterarie, note al testo*, Meravigli Editrice, Vimercate.
- TERRACINI Benvenuto A., (1982), *Analisi Stilistica, Teoria, storia e problemi*, Feltrinelli, Milano.
- TORRE E., (1994) *Teoria de la traducción literaria*, Sintesis, Madrid.
- X x x x x , (1987) *A textbook of translation*, Prentice Hall, Londër.
- X x x x x, (1993), *Il fu Mattia Pascal, Testo integrale, schede storiche e letterarie, note al testo*, Meravigli Editrice, Vimercate.
- X x x x x, (2000), *Tri herë vetëvrasës*, përkthyer nga Sabah Ramja, Helena Kadare, Shkodër.
- X x x x x, (2002) *I ndjeri Matia Paskal*, përkthyer nga Violanda Canko, Elena Gjika, Tiranë.